

AKT THEMELIMI
&
STATUT
i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
VIVITECH ALBANIA

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- 1) Sot, më 20 Shkurt 2023, unë, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin VIVITECH ALBANIA
- 2) Themelues të shoqërisë janë: Rixhi Koçi, i biri i Agimit, i datëlindjes 02.06.1998, shtetas Shqiptar lindur në Tiranë, identifikuar me Nr. identifikimi J80602060S, Banues në Tiranë.

Neni 2

Objekti

Aktivitete që përfshihen në fushën e Inxhinieri Informatike me profil të Sigurisë së Informacionit dhe disenjimi dhe zhvillimi i sistemesh të sigurisë, ku përfshihet analiza e kërkesave të sigurisë së klientit, projektimi i arkitekturës, instalimet dhe konfigurimet e komponentëve, vendosja në punë, testimet e sigurisë dhe mirëmbajtja përkatëse. Zhvillimi i sistemesh migrimi ku përfshihet transferimi i të dhënave dhe infrastrukturës përkatëse nga teknologji e vjetër në një teknologji të re. Përmirësim/upgrade i sistemesh informatike, operimi, menaxhimi, suporti i përdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik për sistemet software etj. Shoqëria mund në fund, në rrugë të instrumentalizuar, të kryejë çdo operacion tregtar, imobiliar e bankar (duke futur edhe aktivitetin e ndërmjetësimit,

A handwritten signature in blue ink, consisting of several loops and strokes, located at the bottom left of the page.

veprimeve financiare), mundet gjithashtu të marrë kredi, sidoqoftë të garantuara, të japë garanci (duke fituar besueshmërinë dhe impenjimin) edhe në favor të të tretëve, si dhe të marrë përsipër pjesëmarrjen dhe interesimin në shoqëri të tjera ose ndërmarrje që kanë të njëjtin objekt, e gjitha për qëllimin e vazhdimit të objektit të shoqërisë, e vetëm që të ushtrohet me vazhdimësi.

Prodhimit/zhvillimit të software-ve; Implementim sisteme; Inxhinierimi i Sistemeve Software - Proçeset e Ciklit të Jetës së Software; Disenjim software-I; Analizë e kërkesave të sistemit software; projektim i arkitekturës dhe projektimi i detajuar i sistemit software; Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software;

Programim i sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i te gjithë komponenteve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet (pas momentit që software-i është vendosur në operim), mirembajtja e të gjithë komponentëve, suporti i sistemit si një tërësi komponentësh, që në funksionimin e tyre realizojnë qëllimin e zgjidhjes informatike;

Testim software, ku përfshihet testimi i funksionaliteteve, të ngarkesës në punë, të performancës, të pranimit, të disponueshmërisë dhe të sigurisë së sistemit software. Disenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit ku përfshihet analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja në punë dhe mirëmbajtja e sistemeve të komunikimit të rrjeteve të pajisjeve informatike.

Design, programim, menaxhim i faqeve të internetit, i aktiviteteve promocionale me përdorimin e postës elektronike (e-mail), i zonave reklamore në faqe të internetit të palëve të treta nëpërmjet banner dhe/ose mjeteve të tjera promocionale interaktive, i programeve informatike si psh: widgets, mobile apps, social network apps, interactive e- cards, i fushatave reklamore në gazeta, revista, TV, radio, si edhe në vende publike.

Programim dhe menaxhim i aktivitetit promocional me përdorim të SMS. Programim dhe menaxhim i bazave të të dhënave informatike të klientëve për arsye promocionale. Këshillim të klientëve për çështje marketingu, marrëdhënie me publikun dhe të brandit. Shitje dhe/ose blerje e produkteve e shërbimeve në internet (e- commerce).

Këshillim, studim, programatizim dhe menaxhim i fushatave reklamore në search engine. Të zhvillojë aktivitet në fushën e prodhimit dhe shitjes së software (programe), instalim, vënie në punë, trajnime, konsulenca e të tjera ndihmese për këtë fushë. Shitje online dhe botimin e librave, gazetave dhe mediave online, tv online dhe radio online. Prodhimin dhe shitjen e reklamave.

Konsulencë për zhvillim biznesi dhe hartim planesh biznesi të fushave të ndryshme. Konsulencë financiare për projekte të ndryshme që mund të kenë kërkesa biznesi dhe klientët.

Zhvillim dhe ndjekje proçesesh të ndryshme në zgjerimin dhe rritjen e aktiviteteve të bizneseve.

A handwritten signature in blue ink, consisting of a stylized letter 'R' followed by several horizontal strokes.

Asistencë, konsulencë dhe hartim praktikash të plota (duke përfshirë dhe plan biznesin) për kreditim në sektorin bankar dhe atë të mikrofinancimi. Tregtimin e pajisjeve elektronike, kamerave dhe sistemeve të 3 sigurisë. Ofrimi i shërbimeve të ndryshme si domaine dhe hosting. Konsulencë juridike, përfaqësime ligjore, ndërmjetësim.

Blerje shitje Hardware, kompjutera, aksesore dhe pjesë të tyre, kompjutera, hardware dhe aksesore të tjerë, instalim e mirëmbajtje të tyre,

Tregtim me shumicë dhe pakicë i të gjithave artikujve kancelarike, kompjuterike, printerave, artikuj zyrash, bojra për printera, artikuj elektrike, informatik, elektronik, artikuj të ndryshme, multimedia, fotografike.

Asistencë teknike, instalime, riparime dhe mirëmbajtje e të gjithave paisjeve elektronike, kompjuterike dhe printimit. Montim dhe mirëmbajtje të sistemeve të vëzhgimit, sigurisë dhe audio, si dhe instalime elektrike të çdo lloji. Tregtim i materialeve të konsumit dhe pjesëve për artikujt kompjuterike, elektrike dhe printimit.

Shoqëria gjithashtu do të jetë në gjendje të kryejë çdo dhe të gjitha transaksionet e pasurive të paluajtshme, të luajtshme dhe ekonomike të lidhura ose që kanë të bëjnë me qëllimin e korporatës, të ndërmarrë investime të kapitalit në kompani të tjera me qëllime të ngjashme ose të lidhura me të vetën, duke përjashtuar çdo qëllim vendosjeje, dhe së fundi, japin garanci.

Mund të hapë degë dhe adresa dytësore; Për rrjedhojë, ajo mund të marrë pjesë edhe në kontratat e dhëna nga organet publike dhe private, mund të fitojë, drejtpërdrejt dhe tërthorazi, interesa dhe aksione në kompani ose shoqëri të tjera private ose publike që kanë një objekt analog ose të ngjashëm ose të lidhur me të vetën.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një kohë të pacaktuar duke filluar nga data e themelimit të saj.

Neni 4

Selia

- 1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Bardhyl, Njësia Bashkiake 4, Pallati Progen, Kati3, Ap.12, Tiranë, Shqipëri.
- 2) Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është:
- 3) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është: info@vivitech.al
- 4) Numri kontaktit të shoqërisë për qëllime komunikimi është: 0696903330

A handwritten signature in blue ink, consisting of a stylized, cursive script.

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 200.000 Lekë (dyqindmijë lekë).

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- 1) Ortaku themelues: Rixhi Koçi, i biri i Agimit, i datëlindjes 02.06.1998, shtetas Shqiptar lindur në Tiranë, identifikuar me Nr. identifikimi J80602060S është Zotërues i 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 200.000lekë që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.



Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

Organet Vendimmarrëse dhe Drejtuese

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrë i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkr. "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese më të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

A handwritten signature in blue ink, consisting of several loops and a long horizontal stroke.

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

A handwritten signature in blue ink, appearing to be a stylized 'A' or similar character.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR (QKB) për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12

Përgjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

1. Shoqëria do të përfaqësohet ligjërisht nga:
 - Emërohet Rixhi Koçi, l biri i Agimit, lindur më 02.06.1998 në Tiranë, mbajtës i pashaportës Shqiptare J80602060S me detyrë administrator me afat emërimit, është 5 vjet duke nisur nga data e themelimit të shoqërisë, me të drejtë ripërtëritjeje dhe pa kufizime në kompetenca.Specimeni nënshkrimit: 
2. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratoret në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Pëveç kesaj, administratoret shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.
3. Tagrat e përfaqësimit të administratoreve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit.

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të therrasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

- o sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- o shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- o shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbelimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare",



1. administratori detyrohet:
 - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:
 - a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - e) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit Padiësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

A handwritten signature in blue ink, consisting of a stylized, cursive set of initials or a name.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Kreu V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a. kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b. me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c. me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e. me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër". Prishja e

A handwritten signature in blue ink, consisting of a stylized, cursive set of initials.

shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pague, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Përsa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të treteve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptar.

ORTAKE

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

VIVITECH ALBANIA

Rixhi Koshi 